


Climate 5000 M

CL5000M 41/2 E | CL5000M 53/2 E | CL5000M 62/3 E | CL5000M 79/3 E | CL5000M 82/4 E | CL5000M 105/4 E | CL5000M 125/5 E

bg	Климатик Multi-Split-Klimagerät Multifunkčni	Ръководство за монтаж за специалисти	2
cs	Multifunkční splitová klimatizační jednotka	Návod k instalaci pro kvalifikované pracovníky	23
da	Multi-Split-klimaapparat	Installationsvejledning til installatøren	42
de	Multi-Split-Klimagerät	Installationsanleitung für die Fachkraft	61
el	Κλιματιστικό τύπου Multi-Split	Οδηγίες εγκατάστασης για τον εξειδικευμένο τεχνικό	81
en	Multi-Split air conditioner	Installation instructions for the qualified person	102
es	Climatizador Multi-Split	Manual de instalación para el técnico	122
et	Multisplit-kliimaseade	Paigaldusjuhend spetsialistile	142
fr	Climatiseur Multisplit	Notice d'installation pour le spécialiste	162
hr	Multi-split klima-uređaj	Upute za instalaciju za stručnjaka	182
hu	Multi-split klímakészülék	Szerelési útmutató szakemberek számára	201
it	Condizionatore Multi Split	Istruzioni per l'installazione per il tecnico specializzato	221
lt	"Multi-Split" kondicionierius	Montavimo instrukcija specialistams	241
lv	"Multi-Split" gaisa kondicionēšanas iekārta	Montāžas instrukcija speciālistam	261
mk	Мулти-сплит клима уред	Упатства за инсталација за техничари	280
nl	Multi-Split-airconditioning	Installatie-instructie	300
pl	Urządzenie klimatyzacyjne Multi Split	Instrukcja montażu dla instalatora	320
pt	Ar condicionado Multi-Split	Manual de instalação para técnico especializado	340
ro	Aparat de aer condiționat tip multi-split	Instrucțiuni de instalare pentru personalul specializat	360
sk	Multifunkčné splitové klimatizačné zariadenie	Návod na inštaláciu pre odborného pracovníka	380
sl	Multi Split klimatska naprava	Navodila za namestitev za strokovnjaka	400
sq	Kondicioner Multi Split	Udhëzimet e instalimit për specialistin	419
sr	Multi-split klima-uređaj	Uputstvo za instalaciju za stručna lica	438
tr	Multi Split Klima	Montaj kılavuzu	458
uk	Багатозональна спліт-система кондиціонування	Інструкція з монтажу та технічного обслуговування для фахівців	480



Përmbajtja

1	Shpjegimi i simboleve dhe udhëzimet e sigurisë	420	5.1	Pozicionet e çelësve DIP për njësitë me kasetë dhe për kanal	429
1.1	Shpjegimi i simboleve	420	5.2	Cilësimet e çelësit DIP për njësitë me konsolë	430
1.2	Këshilla të përgjithshme sigurie	420	5.3	Konfigurimi i pultit me tel (njësia për kanal)	431
1.3	Shënimet në këtë manual	421	6	Vënia në punë	431
2	Të dhëna për produktin	421	6.1	Lista e kontrollit për vënien në punë	431
2.1	Deklarata e konformitetit	421	6.2	Prova funksionale	432
2.2	Pasqyra e llojeve	421	6.3	Funksioni për korrigjimin automatik të gabimeve të lidhjes	432
2.3	Kombinimet e rekomanduara të njësive	421	6.4	Dorëzimi te përdoruesi	432
2.4	Pajisjet e lëvruara	421	7	Zgjidhja e problemeve	432
2.5	Përmasat dhe distancat minimale	422	7.1	Konflikti i modaliteteve	432
2.5.1	Njësia e brendshme dhe njësia e jashtme	422	7.2	Gabimet me tregues	432
2.5.2	Linjat e freonit	422	7.3	Gabime pa tregues	433
2.5.3	Zona e mbrojtjes	422	8	Mbrojtja e ambientit dhe hedhja	433
3	Informacion për freonin	423	9	Të dhënat teknike	434
4	Instalimi	423	9.1	Njësi të jashtme	434
4.1	Përpara instalimit	423	9.2	Njësi të brendshme	437
4.2	Kërkesat për vendin e instalimit	423			
4.3	Montimi i pajisjes	424			
4.3.1	Montojeni në tavan njësinë me kasetë ose njësinë për kanal	424			
4.3.2	Montimi i kapakut CL5000iU 4CC	424			
4.3.3	Montimi i kapakut CL5000iL 4C	425			
4.3.4	Montimi i njësisë me konsolë në mur	425			
4.3.5	Montimi i njësisë së murit në mur	425			
4.3.6	Montimi i njësisë së jashtme	425			
4.4	Instalimi i linjës së ajrit në njësinë për kanal	425			
4.4.1	Instalimi i tubit dhe i aksesorëve	425			
4.4.2	Rregulloni drejtimin e hyrjes së ajrit (nga mbrapa për poshtë)	426			
4.4.3	Instalimi i tubit të ajrit të freskët	426			
4.5	Instalimi i tubit të ajrit të freskët në njësitë me kasetë	426			
4.6	Lidhja e tubacionit	426			
4.6.1	Lidhni linjat e freonit në njësitë e brendshme dhe të jashtme	426			
4.6.2	Lidhni shkarkuesin e kondensatit në njësinë e brendshme për montimin në mur	426			
4.6.3	Lidhja e shkarkuesit të kondensatit në njësitë e brendshme për montimin në mur	427			
4.6.4	Prova e shkarkimit të kondensatit	427			
4.6.5	Kontrolli i shtrëngimit dhe mbushja e sistemit	427			
4.7	Montimi i pultit me tel (njësia për kanal)	427			
4.8	Lidhja elektrike	427			
4.8.1	Këshilla të përgjithshme	427			
4.8.2	Lidhja e njësisë së jashtme	428			
4.8.3	Shënim për lidhjen e njësive të brendshme	428			
4.8.4	Lidhja e njësisë për kanal	428			
4.8.5	Lidhja e njësisë me kasetë	428			
4.8.6	Lidhja e njësisë me konsolë	428			
4.8.7	Lidhja e njësisë së murit	429			
4.8.8	Lidhja e aksesorëve të jashtëm (njësitë për kanal dhe me kasetë)	429			
5	Konfigurimi i sistemit	429			

1 Shpjegimi i simboleve dhe udhëzimet e sigurisë

1.1 Shpjegimi i simboleve

Këshilla sigurie

Tek këshillat paralajmëruese, fjalët sinjalizuese karakterizojnë llojin dhe ashpërsinë e pasojave, nëse nuk respektohen masat për parandalimin e rreziqeve.

Fjalët e mëposhtme sinjalizuese janë të përcaktuara dhe mund të jenë përdorur në dokumentin që keni para:

RREZIK

RREZIK do të thotë që mund të shkaktohen dëme të rënda dhe deri me rrezik për jetën.

PARALAJMËRIM

PARALAJMËRIM do të thotë që mund të shkaktohen dëme të rënda deri në rrezik për jetën.

KUJDES

KUJDES do të thotë që mund të shkaktohen dëme të lehta deri të mesme të rënda në persona.





KËSHILLË

KËSHILLË do të thotë që mund të shkaktohen dëme materiale.

Informacione të rëndësishme



Informacionet e rëndësishme pa rreziqe për njerëzit ose sendet shënohen me simbolin informues Info.

Simboli	Kuptimi
	Paralajmërim për substancat e djegshme: freoni R32 në këtë produkt është një gaz me djegshmëri të ulët dhe toksicitet të ulët (A2L ose A2).
	Mbani doreza mbrojtëse gjatë punimeve të instalimit dhe të mirëmbajtjes.
	Mirëmbajtja duhet kryer nga një person i kualifikuar në përputhje me udhëzimet në manualin e mirëmbajtjes.
	Respektoni udhëzimet e manualit të përdorimit gjatë punës.

tab. 737

1.2 Këshilla të përgjithshme sigurie

Udhëzime për grupin e synuar

Ky manual instalimi u drejtohet specialistëve të ftohjes dhe kondicionimit, si dhe inxhinierëve elektrikë. Duhet të respektohen udhëzimet në të gjitha manualët në lidhje me impiantin. Në rast mosrespektimi mund të rezultojnë dëme materiale dhe lëndime në persona deri në rrezikim për jetën.

- ▶ Lexoni udhëzimet e instalimit për të gjithë komponentët e impiantit përpara instalimit.
- ▶ Respektoni këshillat e mëposhtme të sigurisë dhe të mirëmbajtjes.

- ▶ Respektoni rregulloret, rregullat teknike dhe direktivat kombëtare dhe rajonale.
- ▶ Dokumentoni punimet e kryera.

Përdorimi në përputhje me qëllimin e duhur

Njësia e brendshme synohet për instalim brenda ndërtesës me lidhje drejt një njësie të jashtme dhe komponentëve të tjerë të sistemit, p.sh. rregullatorë.

Njësia e jashtme synohet për instalim jashtë ndërtesës me lidhje drejt një a më shumë njësive të brendshme dhe komponentëve të tjerë të sistemit, p.sh. rregullatorë.

Kondicioneri synohet vetëm për përdorim komercial/privat, ku devijimet e temperaturës nga vlerat e përcaktuara nuk shkaktojnë dëme për gjallesat apo materialet. Kondicioneri nuk është i përshtatshëm për rregullimin dhe ruajtjen precize të lagështirës së dëshiruar absolute.

Çdo përdorim tjetër konsiderohet në kundërshtim me përdorimin e parashikuar. Përdorimi i papërshtatshëm dhe dëmet si pasojë e këtij përjashtohen nga detyrimet tona.

Për instalimin në vende të posaçme (garazhe nëntokësore, salla tenike, ballkone apo në ambiente gjysmë të hapura):

- ▶ Fillimisht kini parasysh kërkesat për vendin e instalimit të përcaktuara në dokumentacionin teknik.

Transporti dhe magazinimi

- ▶ Njësi e jashtme për të evituar dëmtimin e kompresorit, transport dhe magazinim vetëm ngritur në këmbë.
- ▶ Lëreni ngritur në këmbë për 24 orë përpara vënies në punë.

Rreziqet e përgjithshme nga freoni

- ▶ Kjo pajisje është e mbushur me freon R32. Gazi i freonit mund të shkaktojë gaze toksike kur bie në kontakt me zjarrin.
- ▶ Nëse ka rrjedhje të freonit gjatë instalimit, ajroseni mirë ambientin.
- ▶ Pas instalimit kontrolloni sistemin për rrjedhje.
- ▶ Mos lejoni substanca të ndryshme nga freoni (R32) që të hyjnë në qarkun e freonit.

Siguria e pajisjeve elektrike për përdorimin në shtëpi dhe për qëllime të ngjashme

Për mënjanimin e rreziqeve nga pajisjet elektrike vlejnjë në përputhje me EN 60335-1 standardet e mëposhtme:

„Kjo pajisje mund të përdoret nga fëmijë mbi 8 vjeç ose nga persona me aftësi të kufizuara fizike, ndijore ose mendore, ose me mungesë përvojë dhe dijesh nëse ata mbahen nën vëzhgim ose udhëzohen në lidhje me përdorimin e sigurt të pajisjes dhe kuptojnë rreziqet që lindin nga përdorimi i saj. Fëmijët nuk lejohen të luajnë me pajisjen. Pastrimi dhe mirëmbajtja nga ana e përdoruesit nuk lejohet të kryhet nga fëmijët pa qenë nën vëzhgim.“

„Nëse dëmtohet linja e lidhjes në rrjet, ajo duhet zëvendësuar nga prodhuesi ose shërbimi i tij i klientit ose një person me kualifikim të ngjashëm, për të mënjeluar rreziqet.“

Dorëzimi te përdoruesi

Gjatë dorëzimit udhëzojeni përdoruesin për përdorimin dhe kontrollin e sistemit të kondicionerit.

- ▶ Shpjegimi i përdorimit - gjatë këtij shpjegimi të trajtohen sidomos veprimet që kanë të bëjnë me sigurinë.
- ▶ Kini sidomos parasysh pikat e mëposhtme:
 - Modifikimi apo riparimi lejohet të kryhen vetëm nga një kompani e specializuar e autorizuar.
 - Për funksionim të sigurt dhe në mbrojtje të ambientit nevojiten së paku inspektime vjetore dhe pastrim-mirëmbajtje me porosi.
- ▶ Tregojini pasojat e mundshme (lëndim deri në rrezik për jetë apo dëmtim i pronës) në rast moskryerjeje apo kryerjeje me mangësi të inspektimit, pastrimit dhe mirëmbajtjes.
- ▶ Dorëzonjani manualat e instalimit dhe përdorimit përdoruesit për t'i ruajtur.

1.3 Shënimet në këtë manual

Figurat mund të gjenden të përmblhedhura në fund të këtij manuali. Teksti përmban referenca për tek ilustrimet.

Produktet mund të ndryshojnë në varësi të modelit të shfaqur në këtë manual.

2 Të dhëna për produktin

2.1 Deklarata e konformitetit

Ndërtimi dhe funksionimi i këtij produkti është në përputhje me direktivat evropiane dhe kriteret plotësuese këmbëtare.

CE Me markimin CE shpjegohet konformiteti i produktit me të gjitha rregullat e zbatueshme ligjore të BE-së, të cilat parashikojnë vendosjen e këtij markimi.

Teksti i plotë i deklaratës së konformitetit është i disponueshëm në internet: www.bosch-homecomfort.gr.

2.2 Pasqyra e llojeve

Në varësi të njësive të jashtme, mund të lidhet një numër i ndryshëm njësish të brendshme:

Lloji i pajisjes	Sasia	
	Lidhjet	Njësitë e brendshme (maks.)
CL5000M 41/2 E	2 × 6,35 mm (1/4")	2
CL5000M 53/2 E	2 × 9,53 mm (3/8")	
CL5000M 62/3 E	3 × 6,35 mm (1/4")	3
CL5000M 79/3 E	3 × 9,53 mm (3/8")	
CL5000M 82/4 E	4 × 6,35 mm (1/4")	4
CL5000M 105/4 E	3 × 9,53 mm (3/8")	
	1 × 12,7 mm (1/2")	
CL5000M 125/5 E	5 × 6,35 mm (1/4")	5
	4 × 9,53 mm (3/8")	
	1 × 12,7 mm (1/2")	

tab. 738 Llojet e pajisjeve të njësive të jashtme

Njësitë e jashtme (CL5000M... E) destinohen vetëm për kombinim me njësitë e brendshme si më poshtë:

Përcaktimi i llojit	Lloji i pajisjes
CL5000iU D...	Njësi për kanal
CL5000iU ... C/CC	Njësi me kasetë
CL5000iU CN...	Njësia me konsolë
CL2000 UW... E/ CL3000iU W ... E/ CL5000iU W ... E/ CL6000iU W ... E	Njësi muri

tab. 739 Llojet e njësive të brendshme

2.3 Kombinimet e rekomanduara të njësive

Tabelat nga faqja 516 tregojnë mundësitë e kombinimit të njësive të brendshme me nga një njësi të jashtme. Nëse është e mundur, ruajeni lidhjen më të madhe për njësinë e brendshme më të madhe. Nëse nuk përdoren të gjitha lidhjet, shpërndarja në lidhje mund të zgjidhet lirisht.



Kombinimi i njësive të brendshme mund të zgjidhet midis 40% dhe 130% të fuqisë së njësive të jashtme. Me funksionim konstant të njëkohshëm të njësive të brendshme nuk duhet tejkaluar 100% i fuqisë së njësive të jashtme.

Tabelat tregojnë përcaktimet e rendimentit të njësive të jashtme dhe të brendshme në njësi matëse termike britanike (BTU). Tabela 740 tregon konvertimin në kW.

kBTU/h	kW
7	2
9	2,6
12	3,5
17	5,0
18	5,3
24	7,0
27	7,9
28	8,2
36	10,6
42	12,3

tab. 740 Konvertimi kBTU/h në kW

Shembull: CL5000M 62/3 E + 2 × CL...W/C/CC/D/CN

P _{A+...+P_C} [kBTU/h]	P _{A...P_C} [kBTU/h]		
	A	B	C
14	7	7	-
16	9	7	-
...

tab. 741 CL5000M 62/3 E + 2 × CL...W/C/CC/D/CN

Tabela 741 tregon kombinimet e mundshme të një totali prej 2 njësish të brendshme CL5000M 62/3 E:

- A...C Lidhja A deri C në njësinë e lashtme
- P_{A+...+P_C} Fuqia totale e të gjitha njësive të lidhura të brendshme
- P_{A...P_C} Fuqia nga njësia e brendshme në lidhjen A deri C

2.4 Pajisjet e lëvruara

Në varësi të përbërjes së sistemit, pajisjet e dorëzuara mund të jenë të ndryshme. Përbajtja e dërgesës për pajisjet e mundshme shfaqet në figurën 76. Paraqitja e pajisjeve është për ilustrim dhe mund të ndryshojë në realitet.

Njësia e jashtme (A):

- [1] Njësia e jashtme (mbushur me freon)
- [2] Bërryl shkarkues me guarnicion (për njësinë e jashtme me bazament apo suport muri)
- [3] Paketa e dokumentacionit të produktit
- [4] Unaza magnetike (numri varet nga lloji i pajisjes)
- [5] Adaptor për lidhjet e tubave (në varësi të llojit të pajisjes)

Lloji i pajisjes	Diametri i adaptorit në [mm]	Numri i unazave magnetike
CL5000M 41/2 E	-	6
CL5000M 53/2 E	-	6
CL5000M 62/3 E	1 × Ø 9,53 → Ø 12,7	3
CL5000M 79/3 E	1 × Ø 9,53 → Ø 12,7	3
CL5000M 82/4 E	1 × Ø 12,7 → Ø 9,53	8
CL5000M 105/4 E	1 × Ø 12,7 → Ø 9,53	8
CL5000M 125/5 E	1 × Ø 9,53 → Ø 12,7 1 × Ø 12,7 → Ø 9,53	11

tab. 742 Adaptorët dhe unazat e përfshira magnetike

Njësia e brendshme (B):

- [1] Njësi muri
- [2] Njësi me kasetë
- [3] Njësi për kanal
- [4] Njësia me konsolë



Pajisjet e lëvruara varen nga njësia e brendshme përkatëse (→ dokumentacioni teknik i njësive të brendshme).

Komponentët e mundshëm të pajisjeve të lëvruara të njësive të brendshme (C):

- [1] Paketa e dokumentacionit të produktit
- [2] Filtri i katalizatorit të ftohtë (i zi) dhe biofiltri (i gjelbër)
- [3] Komandimi nga distanca
- [4] Telekomandë me kllapë, me vidë montimi
- [5] Materiali i fiksimit (vida e upa)
- [6] Materiali termoizolues për tubacione
- [7] Dado bakri
- [8] Kabllo komunikimi për lidhje nga njësia e brendshme në njësinë e jashtme
- [9] Tako vibrimi për njësinë e jashtme
- [10] Njësia e ekranit
- [11] Pulti me tel
- [12] Bateritë petë
- [13] Kablloja zgjatuese për pultin me tel (6 m)
- [14] Kablloja zgjatuese për njësinë e ekranit (2 m)
- [15] Gropa tavani dhe bulona suporti
- [16] Shablloni i montimit
- [17] Kabllo lidhjeje dhe mbajtëse (përdoret për portëkalimin IP të aksesoreve opsionalë)
- [18] Kapëse kabllosh

2.5 Përmasat dhe distancat minimale

2.5.1 Njësia e brendshme dhe njësia e jashtme

Njësia e jashtme

Figurat 77 deri 78.

Njësi për kanal

Figurat 89 deri 90.

- [1] Lidhja e tubit të ajrit të freskët
- [2] Hyrja e ajrit
- [3] Filtri i ajrit/dalja e ajrit
- [4] Filtri i ajrit/dalja e ajrit (pas konvertimit)
- [5] Njësia e komandimit elektrik

Njësi me kasetë

Figurat 103 deri 106.

- [1] Linjat e freonit
- [2] Shkarkimi i kondensatit
- [3] Lidhja e tubit të ajrit të freskët (rrumbullake)

Njësia me konsolë

Figura 119.

Njësi muri

Figura 129

Pulti me tel

Figura 97

2.5.2 Linjat e freonit

Legjenda për figurën 79:

- [1] Tubi i anës së gazit
- [2] Tubi i anës së lëngut
- [3] Bërryli në formë sifoni si ndarës vaji



Nëse njësitet e brendshme vendosen më poshtë se njësia e jashtme, kryeni një hark në formë sifoni në anën e gazit pas 6 m maksimumi dhe hark të mëtejshëm në formë sifoni çdo 6 m (→ fig. 79, [1]).

- ▶ Në varësi të llojit të pajisjes së njësive të jashtme, respektoni numrin maksimal të njësive të brendshme të lidhura.
- ▶ Dallimi me gjatësi maksimale të tubit lartësisë maksimale midis njësive të brendshme dhe të jashtme. (→ fig. 80).

Lloji i pajisjes	Gjatësia maksimale totale e tubit ¹⁾ [m]	Gjatësia maksimale e tubit për lidhje ¹⁾ [m]
CL5000M 41/2 E	≤ 40	≤ 25
CL5000M 53/2 E		
CL5000M 62/3 E	≤ 60	≤ 30
CL5000M 79/3 E		
CL5000M 82/4 E	≤ 80	≤ 35
CL5000M 105/4 E		
CL5000M 125/5 E		

1) Ana e gazit ose e lëngut

tab. 743 Gjatësitë e tubit

- ▶ Respektoni diametrin e tubit dhe specifikimet të mëtejshme.

Diametri i tubit [mm]	Diametri i tubit alternativ [mm]
6,35 (1/4")	6
9,53 (3/8")	10
12,7 (1/2")	12

tab. 744 Diametri i tubit alternativ

Specifikimi i tubave	
Gjatësia min. e tubit	3 m
Gjatësia standarde e tubit	7,5 m
Freon shtesë me gjatësi tubi mbi 7,5 m (ana e lëngut)	Në Ø 6,35 mm (1/4"): 12 g/m Në Ø 9,53 mm (3/8"): 24 g/m
Trashësia e tubit	Në Ø 9,53 mm (3/8"): ≥ 0,8 mm. Në Ø 15,9 mm (5/8"): ≥ 1,0 mm
Trashësia e termoizolimit	≥ 6 mm
Materiali i termoizolimit	Shkumë polietileni

tab. 745

2.5.3 Zona e mbrojtjes

Produkti përmban freonin R32, që ka dendësi më të lartë se ajri. Në rast rrjedhjeje, freoni mund të grumbullohet pranë dyshemesë. Ndaj duhet parandaluar grumbullimi i freonit në këndet, shkarkuesit apo të çarat e ndërtesës.

Brenda zonës së përcaktuar të mbrojtjes përreth pajisjes nuk lejohen pjesë të hapura të ndërtesës si p.sh. puse ndriçimi, baxha, valvula, tuba shkarkimi, hyrje bodrumesh, dritare apo dyer. Zona e mbrojtur nuk duhet t'u mbivendoset hapësirave publike apo objekteve në krah.

Nuk lejohen burime ndezjeje si p.sh. automatë, llamba apo çelësa elektrike brenda zonës së mbrojtjes.

Zona e mbrojtjes me njësi të jashtme me qëndrim në dysHEME në një mur




fig. 64 Zona e mbrojtjes, njësi e jashtme me qëndrim në dysHEME në një mur - përmasat në mm




fig. 65 Zona e mbrojtjes kur vendoset përtokë në objekt apo në çati - përmasat në mm

F Pjesa e parme

Zona e mbrojtjes me njësi të jashtme me qëndrim në dysHEME në një kënd




fig. 66 Zona e mbrojtjes, njësi e jashtme me qëndrim në dysHEME në një kënd - përmasat në mm

3 Informacion për freonin

Kjo pajisje **përmban gaze të fluorinuara të efektit serrë**, si p.sh. freon. Pajisja është e mbyllur hermetikisht. Informacioni për freonin sipas rregullores së BE-së nr. 517/2014 për gazet e fluorinuara të efektit serrë mund të gjendet në udhëzimet e përdorimit të pajisjes.



Shënim për instaluesin: Kur rimbushni me freon, plotësoni sasinë shtesë të mbushjes dhe sasinë totale të freonit në tabelën e „informacionit të freonit“ tek udhëzimet e përdorimit.

4 Instalimi

4.1 Përpara instalimit

! KUJDES

Rrezik lëndimi për shkak të skajeve të mprehta!

- Mbani doreza mbrojtëse gjatë instalimit.

! KUJDES

Rrezik djegieje!

Tubat bëhen shumë të nxehtë gjatë funksionimit.

- Sigurohuni që tubat të ftohen përpara se t'i prekni.

- Kontrolloni tërësinë e dorëzimit.

- Kontrolloni nëse vrimat ka si fërshëllimë për shkak të presionit negativ gjatë hapjes së tubave të njësisë së brendshme.

4.2 Kërkesat për vendin e instalimit

- Respektoni distancat minimale (→ kapitulli 2.5 në faqen 422).
- Respektoni hapësirën minimale.

Lartësia e instalimit [m]	Freoni [kg]							
	1,0	1,1	1,2	1,3	1,4	1,5	1,6	1,7
	Hapësira minimale [m ²]							
0,6	9,0	10,5	12,5	14,5	17,0	19,5	22,0	25,0
1,8	1,0	1,5	1,5	2,0	2,0	2,5	2,5	3,0
2,2	1,0	1,0	1,0	1,5	1,5	1,5	2,0	2,0

tab. 746 Sipërfaqja minimale e zonës (1 në 3)

Lartësia e instalimit [m]	Freoni [kg]							
	1,8	1,9	2,0	2,1	2,2	2,3	2,4	2,5
	Hapësira minimale [m ²]							
0,6	28,0	31,0	34,5	38,0	41,5	45,5	49,5	54,0
1,8	3,5	3,5	4,0	4,5	5,0	5,0	5,5	6,0
2,2	2,5	2,5	3,0	3,0	3,5	3,5	4,0	4,0

tab. 747 Sipërfaqja minimale e zonës (2 në 3)

Lartësia e instalimit [m]	Freoni [kg]			
	2,6	2,7	2,8	
	Hapësira minimale [m ²]			
0,6	58,0	63,0	67,5	
1,8	6,5	7,0	7,5	
2,2	4,5	5,0	5,0	

tab. 748 Sipërfaqja minimale e zonës (3 në 3)

Informacion për njësitë e jashtme

- ▶ Mos e ekspozoni njësinë e jashtme ndaj avujve të vajit të motorit, avujve të llixhave, gazit sulfurik etj.
- ▶ Mos e instaloni njësinë e jashtme drejtpërdrejt në ujë as mos e ekspozoni ndaj erës detare.
- ▶ Njësia e jashtme duhet të jetë gjithnjë pa dëborë.
- ▶ Nuk duhet të ndërhyjë ajri i shkarkuar apo zhurma e funksionimit.
- ▶ Ajri duhet të qarkullojë mirë përreth njësisë, por pajisja nuk duhet të ekspozohet ndaj erërave të forta.
- ▶ Kondensati i krijuar gjatë funksionimit duhet të lihet të rrjedhë lirshëm. Nëse është nevoja, instaloni një zorrë kullimi. Në rajonet e ftohta nuk rekomandohet të instaloni zorrë kullimi pasi mund të ngrijë.
- ▶ Vendoseni njësinë e jashtme në një bazë të qëndrueshme.

Informacion i përgjithshëm për njësitë e brendshme

- ▶ Mos e instaloni njësinë e brendshme në një ambient ku ka në punë burime të hapura ndezjeje (p.sh. flakë të lira, pajisje gazi në punë apo sistem ngrohjeje elektrike në punë).
- ▶ Vendi i instalimit nuk duhet të jetë më lart se 2000 m mbi nivelin e detit.
- ▶ Mbajini hyrjen dhe daljen e ajrit pa pengesa, që ajri të mund të qarkullojë lirshëm. Përndryshe mund të ketë rënie të rendimentit dhe zhurmë më të lartë.
- ▶ Mbajini televizorët, radiot dhe pajisjet e ngjashme të paktën 1 m larg pajisjes dhe telekomandës.
- ▶ Mos e instaloni njësinë e brendshme në dhoma me shumë lagështi (p.sh. banja apo dhoma lavanderie).
- ▶ Njësitë e brendshme me pakacitet ftohës prej 2,0 deri në 5,3 kW janë krijuar për një dhomë të vetme.

Shënime për njësitë e brendshme me montim në tavan

- ▶ Konstruksioni në tavan si dhe i varur (në vend) duhet të jetë i përshtatshëm për peshën e pajisjes.
- ▶ Kini parasysh hapësirën minimale.

Shënime për njësitë e brendshme me montim në mur

- ▶ Për instalimin e njësisë së brendshme, zgjidhni një mur që i amortizon dridhjet.
- ▶ Kini parasysh hapësirën minimale.

Shënime për pultin me tel (njësia për kanal)

- ▶ Temperatura e ambientit në pikën e instalimit duhet të jetë në diapazonin e mëposhtëm: -5...43 °C.
- ▶ Lagështia relative në pikën e instalimit duhet të jetë në diapazonin e mëposhtëm: 40. 90 %.

4.3 Montimi i pajisjes

KËSHILLË

Mund të ndodhë dëmtim i materialit për shkak të montimit të pasaktë!

Montimi i pasaktë mund të sjellë rënie e pajisjes nga muri.

- ▶ Montojeni pajisjen vetëm në një mur të fiksuar e të rrafshët. Muri duhet të ketë mundësinë të mbajë peshën e pajisjes.
- ▶ Përdorni vida e upa të përshtatshme për tipin e murit dhe peshën e pajisjes.

4.3.1 Montojeni në tavan njësinë me kasetë ose njësinë për kanal



Ne rekomandojmë t'i përgatitni tubat që përpara varjes së njësisë së brendshme, që të mbetet vetëm lidhja e tubave në fund.

- ▶ Hapeni kartonin nga lart dhe nxirrni njësinë e brendshme.
- ▶ Përcaktoni vendin e montimit, duke marrë parasysh distancat minimale dhe orientimin e tubave:
 - Njësia me kasetë: fig. 103 deri 106
 - Njësia për kanal: fig. 89 deri 90



Sigurohuni që pajisja të përshtaten midis mbajtjes së ngarkesës dhe tavanit artificial.

- ▶ Në rast njësie me kasetë, paneli duhet të jetë rrafsh me tavanin artificial.
- ▶ Njësia për kanal duhet të ketë një distancë minimumi 24 mm nga taveni artificial.

- ▶ Fiksioni dhe shënimi pozicionin e bulonave të varjes në tavan.



RREZIK

Rrezik plagosje!

Dizajni i shtrëngimit të tavanit duhet të jetë i përshtatshëm për peshën e njësisë së brendshme. Për drejtim të saktë të lartësisë rekomandojmë shufra me filetimit M10. Dadot dhe rondelat përkatëse përfshihen me njësinë e brendshme.



RREZIK

Rrezik plagosje!

Do të duhet të paktën dy persona për ta varur dhe fiksuar pajisjen.

- ▶ Mos e montoni të vetëm pajisjen.

- ▶ Vareni pajisjen në bulonat e varjes me rondelat dhe dadot gjashtëkëndore të përfshira në përmbajtjen e dërgesës.
- ▶ Drejtojeni njësinë e brendshme me ndihmën e dadove në shufrat e filetuara.

KËSHILLË

Nëse pajisja varet shtrembër, mund të ndodhin rrjedhje kondensimi.

- ▶ Për niveluar pajisjen përdorni nivelues me lëng.

- ▶ Korrigjoheni pozicionin e duhur të montimit me dado kyçjeje.

- ▶ Lidhjet e tubave sipas kapitullit 4.6.

4.3.2 Montimi i kapakut CL5000iU 4CC...

- ▶ Hiqeni grilën e hyrjes së ajrit nga kapaku (→ figura 107).
- ▶ Vendoseni kapakun në njësinë e brendshme me vidat e dhëna, duke respektuar orientimin (→ figura 108). Ekranin [2] duhet të ndodhet përballë anës së "shkurtër" të pjesëve elektronike në formë L [1].

- ▶ Kapaku duhet të qëndrojë në nivel dhe i shtrënguar mirë përkundër njësisë së brendshme.

Instalojeni sërish grilën e hyrjes së ajrit vetëm gjatë lidhjes elektrike.

4.3.3 Montimi i kapakut CL5000iL 4C...

- ▶ Hiqeni grilën e hyrjes së ajrit nga kapaku (→ figura 109).
- ▶ Hiqeni kapakun e 4 këndeve (→ figura 110).

KËSHILLË

Dëmtimi i kapakut dhe i ekranit

Ekran i është montuar në një prej kapakëve të heqshëm këndorë dhe mund të dëmtohet kur hiqen këndet.

- ▶ Hapini me kujdes këndet me e anë të një kaçavide dhe tërhiqini.

- ▶ Kapni 4 kapëset e këndeve të kapakut në gjuhëzat e njësisë së brendshme, duke respektuar orientimin (→ figura 111). Nëse është nevoja, lëvizeni kapakun në pozicionin e duhur duke e rrotulluar. Këndi me ekran [2] duhet të orientohet nga pjesa elektronike [3] dhe të ndodhet mbi linjat e freonit [1].
- ▶ Shtrëngojeni gremçin e vidës njëtrajtshë derisa trashësia e shkumës midis kasës dhe daljes së ajrit të kapakut të jetë rreth 4-6 mm. Skaji i kapakut duhet të përfundojë mirë me tavanin.
- ▶ Hiqini pjesët e shkumës nga brenda njësisë.

Instalojeni sërish grilën e hyrjes së ajrit vetëm gjatë lidhjes elektrike.

4.3.4 Montimi i njësisë me konsolë në mur

- ▶ Hapeni kartonin nga lart dhe nxirrni njësinë e brendshme.
- ▶ Vendoseni njësinë e brendshme me kallëpet e paketimit përpara.
- ▶ Vidhosni e hiqni pllakën e montimit mbrapa njësisë së brendshme (→ figura 120). Për të shtruar tubat përgjatë njësisë së brendshme, ne rekomandojmë ta lironi pllakën në fund dhe ta rimontoni më vonë.
- ▶ Përcaktoni vendin e instalimit duke pasur parasysh distancat minimale (→ fig. 119).
- ▶ Fiksojeni pllakën e montimit me një vidë e upë lart, në mes të murit dhe drejtojeni horizontalisht (→ fig. 121).
- ▶ Fiksojeni pllakën e montimit me katër vida e upa të tjera në mënyrë që të qëndrojë rrafsh me murin. Rekomandojmë të përdoren vrimat e shënuara me shigjeta.
- ▶ Shponi murin për kalimin e tubave (pozicioni i rekomanduar në i shpimit në mur është pas njësisë së brendshme → fig. 121).
- ▶ Nëse ka ndonjë xokolaturë, rregullojeni panelin në fund të xokolaturës me ndihmën e veglës (→ figura 122).



Në shumicën e rasteve, rakordet e tubave në njësinë e brendshme ndodhen mbrapa njësisë së brendshme. Ne rekomandojmë shtrirjen e tubave përpara varjes së njësisë së brendshme.

- ▶ Lidhjet e tubave sipas kapitullit 4.6.

- ▶ Nëse është nevoja, përkuleni tubacionin në drejtimin e dëshiruar dhe hapni një vrimë në anë të njësisë së brendshme.
- ▶ Kalojeni tubacionin përmes murit dhe montojeni njësinë e brendshme në pllakën e montimit.
- ▶ Nëse është nevoja, hapni kapakun e parme dhe hiqni bokullën e filtrit (→ figura 123), për të futur filtrin e katalizatorit të ftohtë nga materialet e dërguara.

4.3.5 Montimi i njësisë së murit në mur

- ▶ Hapeni kartonin nga lart dhe nxirrni njësinë e brendshme.
- ▶ Vendoseni njësinë e brendshme me kallëpet e paketimit përpara (→ fig. 130).
- ▶ Vidhosni e hiqni pllakën e montimit mbrapa njësisë së brendshme.
- ▶ Përcaktoni vendin e instalimit duke pasur parasysh distancat minimale (→ fig. 129).

- ▶ Fiksojeni pllakën e montimit me një vidë e upë lart, në mes të murit dhe drejtojeni horizontalisht (→ fig. 131).
- ▶ Fiksojeni pllakën e montimit me katër vida e upa të tjera në mënyrë që të qëndrojë rrafsh me murin.
- ▶ Shponi murin për kalimin e tubave (pozicioni i rekomanduar në i shpimit në mur është pas njësisë së brendshme → fig. 132).
- ▶ Nëse është nevoja ndërroni pozicionin e kullimit të kondensatit (→ fig. 133).



Në shumicën e rasteve, rakordet e tubave në njësinë e brendshme ndodhen mbrapa njësisë së brendshme. Ne rekomandojmë shtrirjen e tubave përpara varjes së njësisë së brendshme.

- ▶ Lidhjet e tubave sipas kapitullit 4.6.

- ▶ Nëse është nevoja, përkuleni tubacionin në drejtimin e dëshiruar dhe hapni një vrimë në anë të njësisë së brendshme (→ fig. 135).
- ▶ Kalojeni tubacionin përmes murit dhe montojeni njësinë e brendshme në pllakën e montimit (→ fig. 136).
- ▶ Palosni kapakun e sipërm dhe hiqni një nga dy bokullat e filtrave (→ fig. 137).
- ▶ Futeni filtrin e dhënë të katalizatorit të ftohtë në bokullën e filtrit dhe rimontojeni bokullën.

Nëse njësia e jashtme duhet hequr nga pllaka e montimit:

- ▶ Tërhiqni pjesën e poshtme të panelit në zonën e dy të futurave dhe tërhiqni njësinë e brendshme përpara (→ fig. 138).

4.3.6 Montimi i njësisë së jashtme

- ▶ Vendoseni kartonin në këmbë.
- ▶ Prisni e hiqni ngjitëset e paketimit.
- ▶ Hiqeni kartonin nga lart dhe hiqni paketimin.
- ▶ Në varësi të tipit të instalimit, përgatisni dhe montoni mbajtësen ose suportin e murit.
- ▶ Vendoseni ose vareni njësinë e jashtme.
- ▶ Kur instalohet me mbajtëse apo suport muri, vendoseni me guarnicion bërrylin e dhënë të kullimit (→ figura 82).
- ▶ Hiqni kapakun për lidhjet e tubave (→ fig. 84).
- ▶ Lidhjet e tubave sipas kapitullit 4.6.

4.4 Instalimi i linjës së ajrit në njësinë për kanal

4.4.1 Instalimi i tubit dhe i aksesoreve



Për të instaluar tubat etj. pajisja duhet të varet siç duhet.



Pa filtër ajri, grimcat e pluhurit mund të qëndrojnë në shkëmbyesin e nxehësive dhe të shkaktojë avari dhe rrjedhje atje.

- ▶ Për të shmangur thithjen mbrapsht të ajrit të nxjerrë nga kondicioneri ose qarkun e shkurtër: Planifikojini daljen dhe hyrjen e ajrit në mënyrë që të mos jenë shumë pranë njëra-tjetrës.
- ▶ Përpara instalimit të filtrit të ajrit, sigurohuni që presioni i tij statik të jetë brenda intervalit të lejuar (→ tabela 749 dhe figurat 143 deri 158).

Legjenda për figurat 143 deri 158:

1	Limitet
2	Pika e matjes
H	E lartë
M	E mesme
L	Ulët

Modeli	Presioni statik (Pa) Diapazoni i presionit
CL5000iM D 21E	0-40
CL5000iM D 26 E	0-40
CL5000iU D 35 E	0-60
CL5000iU D 53 E	0-100
CL5000iU D 70 E	0-160

tab. 749 Presioni i jashtëm statik

i Presioni i jashtëm statik (SP1... 4) mund të caktohet përmes menysë së konfigurimit të pultit me tel.

- ▶ Lidhni gjithnjë tubat e ajrit në pajisje me një stakues për të evituar përçimin e zhurmës nga njësia e brendshme në tubat e ajrimit.
- ▶ Instalojeni linjën e ajrit sipas figurës 91.

Legjenda për figurën 91:

- [1] Termoizolimi
- [2] Stakuesi
- [3] Grila e hyrjes së ajrit
- [4] Hyrja e kontrollit
- [5] Njësi për kanal
- [6] Dalja e ajrit

▶ Për të parandaluar kondeensimin, izoloni tubat.

4.4.2 Rregulloni drejtimin e hyrjes së ajrit (nga mbrapa për poshtë)

Bëjeni konvertimin sipas figurës 92:

- ▶ Hiqeni grilën e filtrit [3].
- ▶ Hiqeni pllakën e ventilatorit [1] dhe flaxhën e hyrjes së ajrit [2].
- ▶ Paloseni fletën e ventilatorit nga mbrapa me 90°.
- ▶ Riinstalojeni pllakën e ventilatorit dhe flaxhën e hyrjes së ajrit në një pozicion të anasjellë.
- ▶ Futeni grilën e filtrit [3] në flaxhën e hyrjes së ajrit.

4.4.3 Instalimi i tubit të ajrit të freskët

Në anën e njësisë për kanal ka një hyrje ajri të freskët, që mund të përdoret nëse është nevoja (→ fig. 89).

i Fluksi maksimal i ajrit 5% mund të futet përmes hyrjes së ajrit të freskët.

4.5 Instalimi i tubit të ajrit të freskët në njësitë me kasete

Në anë ka një hyrje ajri të freskët, që mund të përdoret nëse është nevoja (→ figura 103 dhe figura 104, [3]).

i Fluksi maksimal i ajrit 5% mund të futet përmes hyrjes së ajrit të freskët.

4.6 Lidhja e tubacionit

4.6.1 Lidhni linjat e freonit në njësitë e brendshme dhe të jashtme

! **KUJDES**
Rrjedhja e freonit në lidhjet që pikojnë

Lidhjet e pasakta të tubave mund të shkaktojnë rrjedhjen e freonit.

- ▶ Kur ripërdorni lidhjet me flaxhë, ribëjeni gjithnjë pjesën me flaxha.

i Tubat e bakrit ofrohen në madhësi metrike dhe me inçë, por filetimi i dadove të flaxhave është njëlloj. Rakordet e flaxhave në njësitë e brendshme dhe të jashtme janë krijuar për përmasa në inçë.

▶ Kur përdorni tuba bakri metrikë, ndërrojini dadot e flaxhave me ato për diametrin e përshtatshëm (→ tabela 750).

- ▶ Përcaktoni diametrin dhe gjatësinë e tubit (→ faqja 422).
- ▶ Priteni tubin me prerëse tubash (→ figura 83).
- ▶ Hiqini buzët tubave nga brenda dhe hiqni pullat.
- ▶ Vendosni dadon në tub.
- ▶ Zgjeroni tubin me gotë me bordurë në përmasën nga tabela 750. Dadoja duhet rrëshqasë lehtësisht në buzë por jo përtej saj.
- ▶ Lidhni tubin dhe shtrëngojeni vidën me forcë rrotullimi sipas tabelës 750.

i Për çdo njësi të brendshme ka një çift lidhjeje (ana e gazit dhe ana e lëngut). Çiftet e ndryshme të lidhjeve nuk duhen përzier (→ fig. 81).

- ▶ Përsëritni hapat e mëposhtëm për tubat e tjerë.

KËSHILLË

Efikasiteti i dobësuar për shkak të transferimit të nxehtësisë mes linjave të freonit

- ▶ Izoloni linjat e freonit veçmas njëra-tjetrës.

- ▶ Vendosni e fiksoni izolimin e tubave.

Diametri i jashtëm i tubit Ø [mm]	Forca e rrotullimit [Nm]	Diametri i vrimës me bordurë (A) [mm]	Skaji me bordurë i tubit	Dado e filetuar e paramontuar me bordurë
6,35 (1/4")	18-20	8,4-8,7		3/8"
9,53 (3/8")	32-39	13,2-13,5		3/8"
12,7 (1/2")	49-59	16,2-16,5		5/8"
15,9 (5/8")	57-71	19,2-19,7		3/4"

tab. 750 Karakteristikat e lidhjeve të tubave

4.6.2 Lidhni shkarkuesin e kondensatit në njësinë e brendshme për montimin në mur

Kolektori i kondensatit i njësisë së brendshme është i pajisur me dy lidhje. Nga fabrika vijnë të montuara një zorrë kondensati dhe një tapë, këto mund të ndërrohen (→ fig. 133).

- ▶ Vendosni zorrën e kondensatit me pjerrësi.

4.6.3 Lidhja e shkarkuesit të kondensatit në njësitë e brendshme për montimin në mur

- ▶ Përdorni tuba PVC me diametër të brendshëm 32 mm dhe trashësi muri 5–7 mm.
- ▶ Termoizolohen tubin e shkarkimit për të parandaluar kondensimin.
- ▶ Lidhni tubin e shkarkimit me njësinë e brendshme dhe fiksojeni te lidhja me një kapëse zorre.
- ▶ Vendosni tubin e shkarkimit me pjerrësi (→ njësia me kasetë: fig. 112 dhe 113, njësia për kanal: fig. 93). Me një pompë ekzistuese kondensatit dalja e tubit të shkarkimit mund të jetë më e lartë se e njësisë së brendshme, nëse respektohen përmasat dhe skema e lidhjeve.

KËSHILLË

Rrezik dëmtimi nga uji!

Vendosja e gabuar e tubave mund të sjellë pikim të ujit, kthim të ujit në njësinë e brendshme dhe avari të çelësit të nivelit të ujit.

- ▶ Për të evituar barkun e tubave, vendosni një varëse tubi çdo 1–1,5 m.
- ▶ Shkarkojeni tubin përmes një sifoni në sistemin e kanalizimit.

4.6.4 Prova e shkarkimit të kondensatit



Me një provë shkarkimit të kondensatit mund të sigurohet izolimi i të gjitha pikave të lidhjes.

- ▶ Provojeni shkarkimin e kondensatit përpara mbylljes së tavanit.

Njësia e brendshme pa pompë kondensimi

- ▶ Hidhni rreth 2 l ujë në tabakanë e kondensatit ose tubin e mbushjes së ujit.
- ▶ Sigurohuni që kondensati të shkarkohet saktë.
- ▶ Kontrolloni shtrëngimin e të gjitha xhantove.

Njësia e brendshme me pompë kondensimi

Shkarkimi i kondensimit mund të provohet vetëm pas lidhjes konkret elektrike.

- ▶ Hidhni rreth 2 l ujë në tabakanë e kondensatit ose tubin e mbushjes së ujit (njësitë për kanal → fig. 94).
- ▶ Aktivizimi i modalitetit të ftohjes. Dëgjohet pompa e shkarkimit.
- ▶ Sigurohuni që kondensati të shkarkohet saktë.
- ▶ Kontrolloni shtrëngimin e të gjitha xhantove.

4.6.5 Kontrolli i shtrëngimit dhe mbushja e sistemit

Prova e shtrëngimit dhe e mbushjes kryhet individualisht për çdo njësi të brendshme të lidhur.

- ▶ Pas mbushjes së të gjithë sistemit, rivendoseni kapakun për lidhjet e tubave në njësinë e jashtme.

Kontrolli i shtrëngimit

Respektoni rregulloret shtetërore dhe vendore për testimin e rrjedhjes.

- ▶ Hiqni kapakët e valvulave të një çifti lidhjeje (→ fig. 86, [1], [2] dhe [3]).
- ▶ Lidhni hapësin Schrader [6] dhe manometrin [4] në lidhjen e shërbimit [1].
- ▶ Vidhosni hapësin Schrader dhe hapni valvulën Schrader [1].
- ▶ Lëri valvulat [2] dhe [3] të mbyllura dhe mbushini tubat me azot derisa presioni të jetë 10% mbi presionin maksimal të punës (→ faqja 434).
- ▶ Kontrolloni nëse presioni rri i pandryshuar pas 10 minutash.
- ▶ Çlironi azotin derisa të arrihet presioni maksimal i punës.
- ▶ Kontrolloni nëse presioni nuk ndryshon edhe pas së paku 1 ore.
- ▶ Çlironi azotin.

Mbushja e impiantit

KËSHILLË

Avari për shkak freoni të gabuar

Njësia e jashtme është e mbushur me freon R32 nga fabrika.

- ▶ Nëse duhet shtuar freon, mbusheni vetëm me të njëjtin freon. Mos përzieni tipa të ndryshëm freoni.
- ▶ Shkarkojini tubat me pompë vakuumi (→ fig. 86, [5]) për të paktën 30 minuta në rreth –1 bar (rreth 500 Micron) dhe thajini.
- ▶ Hapni valvulën e anës së lëngut [3].
- ▶ Kontrolloni me manometër [4] nëse rrjedhja është e lirshme.
- ▶ Hapni valvulën e anës së gazit [2]. Freoni shpërndahet në tubat e lidhur.
- ▶ Së fundi kontrolloni kushtet e presionit.
- ▶ Vidhosni hapësin Schrader [6] dhe mbyllni valvulën Schrader [1].
- ▶ Hiqni pompën e vakuomit, manometrin dhe hapësin Schrader.
- ▶ Rivendosni kapakët në valvula.

4.7 Montimi i pultit me tel (njësia për kanal)

KËSHILLË

Dëmtimi i pultit me tel

Hapja e gabuar e pultit me tel ose shtrëngimi i tepruar i vidave mund ta dëmtojë pultin.

- ▶ Mos ushtroni shumë forcë mbi pultin me tel.
- ▶ Hiqni suportin e murit të pultit me tel (→ figura 98).
 - Futni majën e kaçavidës në pikën e përkuljes [1] nga mbrapa pultit me tel.
 - Ngrijeni kaçavidën për të hapur suportin e murit [2].
- ▶ Nëse është nevoja, përgatitni murin dhe kabllon e komunikimit (→ figura 99).
 - [1] Kryeni stukimin ose materialin izolues.
 - [2] Parashikoni harkimin e kabllot.
- ▶ Montojeni suportin e murit në mur (→ figura 100, [1]).
- ▶ Montoni një pult me tel në suportin e murit (→ figura 102).

4.8 Lidhja elektrike

4.8.1 Këshilla të përgjithshme



PARALAJMËRIM

Rrezik për jetën nga rryma elektrike!



Prekja e pjesëve elektrike që janë nën tension, mund të shkaktojë goditje elektrike.

- ▶ Para punimeve në pjesët elektrike, ndërpriteni furnizimin me tension shumëpólësh (siguresa/çelësi LS) dhe sigurojeni ndaj rindezjes pa dashje.
- ▶ Punimet në sistemin elektrik mund të kryhen vetëm nga një electricist i miratuar.
- ▶ Prerja e saktë tërthore dhe automati duhen përcaktuar nga një electricist i miratuar. Për këtë është thelbësor konsumi maksimal i korrentit nga të dhënat teknike (→ shih kapitullin 9, faqja 434).
- ▶ Respektoni masat e sigurisë sipas rregulloreve kombëtare dhe ndërkombëtare.
- ▶ Nëse ka rrezik sigurie në tensionin e linjës apo në rast qarku të shkurtër gjatë instalimit, informojeni operatorin me shkrim dhe mos i instaloni pajisjet pa u zgjidhur problemi.
- ▶ Kryejini të gjitha lidhjet elektrike sipas planit të lidhjeve elektrike.
- ▶ Priteni izolimin e kabllot vetëm me veglat e posaçme.
- ▶ Lidhni mirë kabllot me lidhëse të përshtatshme kabllotsh (përmbytja e dërgesës) me kllapat ekzistuese të montimit/hyrjet e kablllove.

- ▶ Mos lidhni asnjë konsumator tjetër në linjën elektrike të pajisjes.
- ▶ Mos ngatëroni fazën dhe NULIN. Përndryshe mund të shkaktoni avari.
- ▶ Në rast lidhjeje fikse elektrike, instaloni një mbrojtëse nga mbitensioni dhe një automat të përcaktuar për 1,5 herë konsumin maksimal të energjisë së pajisjes.

4.8.2 Lidhja e njësive të jashtme

Në njësinë e jashtme lidhen një kablo ushqimi (3 tela) dhe kabloja e komunikimit të njësive të jashtme (4 tela). Përdorni kablo të tipit H07RN-F me prerje të mjaftueshme tërthore të përçuesit dhe sigurojeni lidhjen me linjën elektrike përmes një siguresë.

- ▶ Sigurojeni kabllon e komunikimit në liruësinë e tendosjes dhe lidhni me klemat L(x), N(x), S(x) dhe  (caktimi i telave në klemat e lidhjes sipas njësive të brendshme) (→ fig. 87).
- ▶ Montoni 1 unazë magnetike në secilën kablo komunikimi, sa më pranë njësive të jashtme të jetë e mundur.
- ▶ Sigurojeni kabllon elektrike në kapëse dhe lidhni me klemat L, N dhe .
- ▶ Shtrëngoni kapakun e lidhjeve.

4.8.3 Shënim për lidhjen e njësive të brendshme

Njësitë e brendshme lidhen me njësinë e jashtme përmes një kabloje komunikimi me 4 tela të tipit H07RN-F. Prerja tërthore e përçuesit të kabllos së komunikimit duhet të jetë së paku 1,5 mm².

Çdo çift lidhjeje i tubave ka një lidhje përkatëse elektrike.

- ▶ Lidhni secilën njësi të brendshme në klemat përkatëse të lidhjes (→ fig. 81).

KËSHILLË


Dëmet në pronë për shkak të lidhjes së gabuar të njësive të brendshme

Secila njësi e brendshme ushqehet me tension nga njësia e jashtme.

- ▶ Lidhni njësinë e brendshme vetëm te njësia e jashtme.

4.8.4 Lidhja e njësive për kanal

Për të lidhur kabllon e komunikimit:

- ▶ Hiqni kapakun e pjesëve elektronike.
- ▶ Sigurojeni kabllon në kapëse dhe lidhni me klemat L, N, S dhe .
- ▶ Vini re caktimin e telave në klemat.
- ▶ Rivendosni kapakët.
